



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Inspeksioni
Periudha Raportuese	Maj 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Zana Gojani

#### 1. PËRMBLEDHJE

Gjatë muajit maj mbarëvajtja e punëve ishte në nivelin e duhur, me përjashtime të emergjencave eventuale të paparashikuara.

Kemi pasur një sulm ndaj inspektorëve gjatë kontrolleve rutinore, si dhe kërcënime gjatë aksionit të rrënimit. Rasti i parë është raportuar në PK, si dhe të dyja rastet janë bërë publike.

#### 2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Përpilimi dhe fuqizimi i rregulloreve të nevojshme, në bashkëpunim me drejtoritë tjera komunale;
- Ristrukturimi;
- Transferimi i Sektorit të mbrojtjes së pyjeve dhe bujqësisë ne Drejtorinë e Inspeksionit;
- Vizita në terren në baza ditore, me qëllim:
  - Parandalimin e uzurpimeve të hapësirave publike dhe komunale;
  - Parandalimin e ndërtimeve pa leje;
  - Parandalimin e ndotjes së ambientit;

- Mbikëqyrja e transportit publik;
- Zbatimin e ligjshmërisë për shitësit ambulantë dhe parkingjet ilegale;
- Zbatimin e ligjshmërisë në fushën e lojërave të fatit;
- Parandalimin e keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit të ujit të pijshëm;
- Mbikëqyrjen e punës së subjekteve juridike dhe afariste, me qëllim të përmbushjes së ligjshmërisë.

### 3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

- Largim i shitësve ambulantë .....94
- Gjoba.....6
- Lëndë të iniciuara për Gjykatën Themelore nga Sektori i komunikacionit .....82
- Konfiskim të automjeteve .....60
- Inspektimet e tarracave verore në hapësira publike pa leje nga DSHPMSH ..... mbi 200
- Transferimi i kompletuar i Sektorit të pylltarisë në Drejtorinë e Inspeksionit.
- Mbi **1100** kontrolle të përgjithshme subjekteve të inspeksionit.

### 4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Përveç punëve dhe kontrolleve të përditshme të Drejtorisë:

- Programi i digjitalizimit të Drejtorisë;
- Testimi i pjesës së digjitalizuar;
- Punimi i doracakut “Rendi komunal”;
- Ristrukturimi;
- Punimi i protokolleve të veprimit etj.

## 5. STATISTIKAT

### 5.1.1. Takimet me palë:

- Sektori i komunikacionit - 20
- Sektori komunal - 102
- Sektori i ndërtimit - 125
- Sektori sanitar - 22

### 5.1.2. Takimet me institucione të tjera:

- Drejtorinë e Urbanizmit –Legalizimit;
- Kryetaren e komitetit lokal, siguria publike qendra;
- Zyrtarë të Ministrisë së Arsimit;
- Kompaninë “Pastrimi”;
- Ministrinë e Transportit etj.

### 5.1.3. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

- Sektori i ndërtimit 72
- Sektori komunal 80
- Sektori i komunikacion 93
- Sektori sanitar 33
- Sektori i pylltarisë 28

## 6. SFIDAT

- Numri i vogël i punonjësve;
- Mungesa e deponisë;
- Mungesa e thertoreve;
- Mungesa e tregut të druve/thëngjillit;
- Mungesa e rregullores për ndotje akustike;
- Mungesa e rregullores për vendpunishte;
- Mungesa e udhëzuesit për tarraca;
- Mungesa e shërbimit “Merimanga”, veçmas për Drejtorinë;
- Mungesa e rregullores për parkingje private;
- Mungesa e ligjit për Prishtinën etj.

## 7. REKOMANDIME

- Shtimi i numrit të punonjësve;
- Caktimi i lokacionit dhe krijimi i kushteve për një deponi legale;
- Krijimi i një thertoreje;
- Caktimi i lokacionit për tregun e druve dhe thëngjillit;
- Takimi me Ministrinë e Ambientit për sqarimin rreth inspektimit të ndotjes akustike;
- Caktimi i grupit punues për rregulloren dhe doracakun për vendpunishte;
- Caktimi i grupit punues për doracakun për shfrytëzimin e tarracave;
- Shtimi i bashkëpunimit mes Drejtorisë së Inspeksionit dhe shërbimit “Merimanga”;
- Caktimi i grupit punues për mbikëqyrjen e parkingjeve private;
- Ligji për Prishtinën.

## 8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

- Përpilimi dhe fuqizimi i rregulloreve të nevojshme, në bashkëpunim me drejtoritë tjera komunale;
- Ristrukturimi;
- Transferimi i Sektorit të mbrojtjes së pyjeve dhe bujqësisë në Drejtorinë e Inspeksionit;
- Vizita në terren në baza ditore, me qëllim të:
  - Parandalimit të uzurpimeve të hapësirave publike dhe komunale;
  - Parandalimit të ndërtimeve pa leje;
  - Parandalimit të ndotjes së ambientit;
  - Mbikëqyrjes së transportit publik;
  - Vendosijes së ligjshmërisë për shitësit ambulante dhe parkingjet ilegale;
  - Vendosijes së ligjshmërisë në fushën e lojërave të fatit;
  - Parandalimi i keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit të ujit të pijshëm;
  - Mbikëqyrja e punës së subjekteve juridike dhe afariste, me qëllim përmbushjen e ligjshmërisë.